



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:186612
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05638000

PA1.nr.1561/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.S nga Gjilani, për shkak të veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe Përdorimi i armës nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-ës, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit F.S av. L.A të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.141/23 të dt.06.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit F.S av. L.A, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.141/23 të dt.06.10.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin, PKR.nr.141/23 të dt.06.10.2023, të akuzuarit F.S e ka shpallur fajtor për shkak veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe Përdorimi i armës nga neni 367 paragrafi 1 të KPRK-ës, dhe i ka shqiptuar dënim unik me gjobë prej 400 (katërqind) euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20€ (njëzetë euro) të dënimit me gjobë, si dhe dënim me burgim

në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet në kuptim të nenit 50 dhe 51 të KPRK-s. Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues, konfiskimi i armës “Zoraki” 917 (armë me gazë). Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, 50 (pesëdhjetë) euro, për viktimat e krimit dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësja e të akuzuarit F.S av. L.A, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e ankimuar, ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim, apo ta ndryshojë sa i përket vendimit mbi dënimin dhe të pandehurit ti shqiptojë një dënim më të butë.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.625/23 të datës 08.12.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit F.S av. L.A, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësja e të akuzuarit F.S av. L.A e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal , me pretendimet se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe është penduar për atë që ka ndodhur mirëpo rrethanat nën të cilat është kryer vepra gjykata nuk i ka marrë parasysh e sidomos rrethanat lehtësuese se nuk është recidivist dhe për herë të parë i ka ndodhur kjo ngjarje, është i martuar dhe baba i tre fëmijëve, është i vetmi mbajtës i familjes, i gjendjes së varfër ekonomike, ka qenë një revole me gaz, ashtu që nuk ka ekzistuar asnjë rrethanë rënduese. Andaj dënimi i shqiptuar konsideron se është tepër i lartë duke pasur parasysh gjendjen ekonomike por edhe të ardhurat mesatare , andaj në bazë të të ardhurave të realizuara duhet të jetë edhe dënimi me gjobë i shqiptuar, andaj konsideron se edhe me një dënim më të butë mundë të arrihet qëllimi i ndëshkimit si dhe nuk do të i rrezikohet ekzistenca familjare. Konsideron se gjykata është dashur ti ketë parasysh të gjitha këto rrethana lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit, tutje pretendoi se dënimi i shqiptuar nuk është në harmoni me dispozitat ligjore as të matjes së dënimit.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk është atakuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarës e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e tij

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit, që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimit me të butë për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, është lajmëruar personalisht në Stacion Policor dhe e ka dorëzuar armën, pendimi dhe premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërisë shoqërore, duke qenë se përdorimi i armës, paraqet rrezik dhe shqetësim për popullatën.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e mbrojtëses së të akuzuarit, nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptoj dënim më të butë. Të gjitha këto rrethana e sidomos duke i marr parasysh pranimin e fajësisë së të akuzuarit, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimit, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1561/23, më datë 24.04.2024

Procesmbajtësja,
Gentijana Manaj-Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Mehmet Ndrecaj

Ferit Osmani